

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

15.01.2025

Ora 11:05

**RENDI I DITËS**

**Shqyrtimi i paraprak i kërkesës nr.14 “Për vendosje sanksioni administrativ”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Belev, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. K.Puleri
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Z. A. Hoxhaj (administrator i TV Koplikut)

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore nr.14. Kërkesë e depozituar në KQZ nga TV Kopliku, kërkesa është protokolluar në KQZ në datë 24.10.2024 dhe në thelb kundërshton vendimin nr. 186, të datës 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ndër të tjera, në pikën 3 të dispozitivit ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë, në masën 100 000 lekë, për ofruesin e shërbimit mediatic audio-viziv TV Kopliku sipas nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor. Është e pranishme trupa e KAS-it me pesë anëtarë, është përfaqësuesja e KQZ-së, është edhe përfaqësuesja e KQZ-së dhe përfaqësuesi i ankuesit.

**Z. A. Hoxhaj, administrator i TV Kopliku:** Z. Artur Hoxhaj, nga TV Kopliku, administratori.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë fillojmë. Përfaqësuesja e KQZ-së në lidhje me elementët e formës dhe përmbajtjes, a plotësohen këto nga ankimuesi? Pastaj ia japim fjalën ankimuesit. Sot jemi vetëm për elementët e formës dhe përmbajtjes, jo themelin e ankimit se s'e di sa i njohur je me procedurat. Znj. Ina për kërkesën nr. 14.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë në lidhje me kërkesën nr. 14 është administruar, me nr.protokolli 3000/1, datë 24.10.2024, depozituar nga televizioni, TV Kopliku, për të kundërshtuar vendimin nr. 186, datë 8.10.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuar nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Nga kërkesa e depozituar shikojmë që ka nevojë që të plotësohet për sa i përket objektit sepse është një detyrime që e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, nëpërmjet së cilës kemi verifikuar veprimet paraprake, çka duhet të plotësojnë një kërkesë ankimore.

**Z. L. Braho:** Pra ju thoni mungon objekti në kuptimin se çfarë kundërshton?

**Znj. I. Osmanaj:** Se çfarë kundërshton kjo kërkesë ankimore.

**Z. L. Braho:** Me afatin është në rregull?

**Znj. I. Osmanaj:** Me afatin po.

**Z. L. Braho:** Dakord. Mbase na e sqaron këtu në seancë. Atëherë çfarë kundërshton konkretisht se unë kur e shoh këtë ankesën, ajo del pak a shumë po thjesht...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. A. Hoxhaj, përfaqësues i TV Kopliku:** Unë kundërshtoj pjesën e gjobës domethënë, pjesën e minutazhit.

**Z. L. Braho:** Pra këtë vendimin 186?

**Z. A. Hoxhaj, përfaqësues i TV Kopliku:** Po.

**Z. L. Braho:** Edhe vetëm për pikën 103 që është gjoba juaj.

**Z. A. Hoxha, përfaqësues i TV Kopliku:** Po, pjesën e minutazhit. Mundohemi me kërkesë të AMA-s, të bëjmë balancimin, në bazë të lajmeve, ndoshta është paguar veç një parti, nga partitë e tjera na është dashur t'i japim pa pagesë, si e si të mbajmë minutazhin.

**Z. L. Braho:** Kuptoj.

**Z. A. Hoxhaj, përfaqësues i TV Kopliku:** Nëse ka një kërkesë për shembull që të mos transmetojmë pa pagesë, asnjë lloj partie është tjetër gjë, po puna është gjithmonë prapë te minutazhi, mos të kapin...

**Z. L. Braho:** Kjo ka të bëjë me themelin.

**Z. A. Hoxhaj, përfaqësues i TV Kopliku:** Patjetër, pa problem, vetëm më thoni orarin.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi ta kaloj për shqyrtim kërkesën ankimore nr. 14, meqenëse i pranishëm është dhe vetë ankuesi dhe administrata e KQZ-së. Seanca për shqyrtimin administrativ do të zhvillohet po sot në datë 15 janar 2025, në orën 11.20

**Vendimi nr.1**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

15.01.2025

Ora 11:11

**RENDI I DITËS**

**Shqyrtimi i paraprak i kërkesës nr.18 “Për vendosje sanksioni administrativ”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. K. Puleri
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** S’ka

**Z. L. Braho:** Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.18. Kërkesë e depozituar në KQZ, në datë 24.10.2024. Po ashtu dhe kjo seancë ka të bëjë me elementët e formës dhe përmbajtjes së kësaj kërkesë ankimore, është depozituar nga televizioni RTV Shkodra, që me sa kuptohet thelbi i shkresës por ashtu kundërshton vendimin 186 të Komisionerit dhe më konkretisht pikën 94, që ka vendosur marrjen e masës administrative gjobë në masën 4 000 lekë, për ofruesin e shërbimit RTV Shkodra, sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor. E pranishme është përfaqësuesja e KQZ-së. Nuk ka të pranishëm nga ankimuesit, kështu që me pak fjalë, përfaqësuesja e KQZ-së në lidhje me elementët e formës dhe përmbajtjes së kësaj kërkesë.

**Znj. I. Osmanaj:** Atëherë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 ka miratuar vendimin për raportin e gjetjeve nga auditimi i

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, i cili në pikën 94 të tij ka parashikuar marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 4 000 lekë për ofruesin e shërbimit mediatic RTV Shkodra sipas neneve 84, pika 5 dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Nëpërmjet kërkesës ankimore e administruar me nr. prot. 3000/2, datë 24.10.2024 depozitohet ankimi kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas dispozitës së nenit 130 të Kodit Zgjedhor janë verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes, konstatohet që dhe në këtë kërkesë mungon elementi i objektit, pra nuk ka një objekt të përcaktuar edhe pse nga përmbajtja e kësaj kërkesë del pak a shumë që kundërshtohet vendimi nr.186 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në këto kushte kërkojmë që të plotësohet ky si element.

**Z. L. Braho:** Po ka një pyetje.

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje, qoftë në kërkesën ankimore që ju e keni quajtur kërkesë ankimore, po kjo në fakt s'ka asnjë element kërkesë ankimore, kjo është një shkresë zyrtare e drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe i thotë që "Në vendim ka një lajthitje, ne nuk jemi RTV Shkodra, por jemi RTSH Shkodra, jemi televizion publik" dhe unë mendoj që këtu nuk kemi fare të bëjmë me kërkesë ankimore, aspak. Komisioneri t'i kthejë përgjigje këtij zotërisë që të sqarojë që është gabim, është shkruar gabim tek vendimi dhe unë e korigjoj ose nuk është shkruar gabim te vendimi dhe e orienton pastaj me procedurë që duhet të ndjekin zyrtarisht për të bërë ankim në KAS, se kjo është shkresë nuk është as drejtuar as KAS-it njëherë, drejtuar Celibashit. S'e kuptoj pse është kërkesë ankimore kjo.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. K. Puleri:** Në lidhje me këtë e kemi referuar si kërkesë ankimore pasi RTV Shkodra na ka ardhur nga AMA, nga monitorimi që bën AMA, nuk e ka bërë RTSH Shkodra, por RTV Shkodra dhe ne këtë e kemi quajtur si televizion publik dhe e kemi sanksionuar për mosdorëzim të tarifave për reklamat politike, privat, po më fal, për reklama politike gjatë fushatës zgjedhore, i jemi drejtuar me një shkresë tjetër AMA-s, në fakt, për ta saktësuar në lidhje që është RTV Shkodra apo RTSH Shkodra, por nuk kemi marrë një përgjigje zyrtare nga AMA për këtë rast sepse në raportet e AMA-s është referuar si RTV Shkodra, jo RTSH Shkodra. Jo mesa pamë ne po nuk na ka ardhur nga AMA një përgjigje zyrtare në lidhje me këtë.

**Z. E. Çefa:** Kjo nuk përbën arsye për ta sjellë te KAS-i, a më kupton? Zgjidheni në rrugë administrative këtë histori, sqaroheni ju dhe rregulloni vendimin e Komisionerit. Kjo s'ka arsye të jenë në KAS mendoj unë, nuk e di tani.

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se subjekti është radio-televizion publik duhet të sanksionohej apo jo?

**Z. K. Puleri:** Jo nuk duhej të sanksionohej.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë, identifikoheni qartë dhe merrni rregulloni vendimin tuaj, është e thjeshtë ajo. Ju keni mundësinë të rregulloni vendimin, nuk do të vimë ne ta rregullojmë vendimin. Është subjekt publik, është dukshëm subjekt publik, nuk duhej të përfshihej në listën e subjekteve private, mund fare mirë me një akt të Komisionerit të thuhet, siç bëmë ne sot një, para ca ditësh një akt tjetër, anulohet për këtë pjesë vendimi dhe çlirohet subjekti nga detyrimet, s'ka nevojë fare është konstatimi i lapsusit që bëhet nga organi vetë. Pse duhet të futet në procedurë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

ankimore konstatimi i lapsusit? Dakord po ju jeni të qartë për identitetin e subjektit apo jo? Jeni të qartë dhe për faktin se subjekti i të drejtës publike nuk duhej të përfshihej, zgjidheni.

**Z. E. Çefa:** Vendimi i Komisionerit është vendim që ky, domethënë ku është vendimi për miratimin e raportit apo është?

**Z. K. Puleri:** Në rastin e televizioneve është vendosur sanksion për këto televizione.

**Z. E. Çefa:** Ndryshohet vendimi dhe hiqet, ky subjekt nuk ka arsye.


**Znj. I. Osmanaj:** Do duhet ta konsultojmë ndoshta me Komisionerin këtë gjë dhe pastaj.

**Z. E. Çefa:** Edhe diçka tjetër, minimalisht ky nuk është në kushtet e ankimit, se ky nuk bën kërkesë ankimore, ky nuk i është drejtuar KAS-it, jemi mbledh kot, po harxhojmë kohën kot me këtë punë. Minimumi që duhet të bëni në qoftë se nuk doni të ndryshoni vendimin, e orientoni drejt subjektin, i thoni ne nuk ta ndryshojmë më vendimin tani, ke vetëm mundësinë ligjore në KAS dhe për në KAS referoju neneve përkatëse të ligjit sesi bëhet kërkesa ankimore.

**Z. I. Rusmali:** Ne s'i japim përgjigje shkresës.

**Z. E. Çefa:** Pikërisht, unë këtë thashë por më shkurt.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi moskalimin, mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 18 sepse nuk është në kompetencën e KAS-it dhe nuk i është drejtuar KAS-it si kërkesë ankimore. Mund ta zgjidhi Komisioneri duke orinetuar subjektin ose duke..meqenëse konstatohet lehtësisht nuk kemi të bëjmë me një televizion privat po me televizion shtetëror. E deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

**Vendimi nr.2**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

15.01.2025

Ora 11:21

***RENDI I DITËS***

**Shqyrtimi paraprak i kërkesës nr.1 të KSHZ-së**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, z. K. Puleri
- **Parti Politike:** S'ka
- **Të tjerë:** S'ka

**Z. L. Braho:** Çelim seancën për shqyrtimin e elementët e formës dhe përmbajtjes së kërkesës nr. 1 të Komisionerit për vitin 2025, është kërkesë me nr.115 protokolli, me të cilën Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar KAS-it në lidhje me një propozim që del si pasajë e vendimit për miratimin e raportit mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimit gjatë implementimit të votimit elektronik në Bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Është vendimi numër 209 i datës 11.12.2024 dhe bazuar në këtë vendimmarrje Komisioneri i ka propozuar KAS-it. Ka rezultuar se në Bashkinë Vorë janë evidentuar tre raste që operatorët, në qendrën e votimit 1546 asiston, ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar; 1549, 1563 pastaj janë 12 propozime për Bashkinë Elbasan, ku po ashtu është vërejtur se operatorët asistojnë, ndihmojnë votuesit dhe në Bashkinë Kamëz dy raste. Bazuar në këto konstatime Komisioneri ka propozuar vendosjen e sanksioneve administrative gjobë në masën 3 000 lekë referuar nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor ndaj operatorëve përgjegjës

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

për shkeljet e konstatuara nga këqyrja. E pranishme është trupa e KAS-it në përbërje të plotë, administrata e KQZ-së dhe mund të na identifikoheni me emër, mbiemër?

**Z. O. Deda:** Osman Deda.

**Z. L. Braho:** O.D? Mirë janë njoftuar të gjithë këta për të cilët është propozuar ky sanksion?

**Znj. I. Osmanaj:** Po janë njoftuar.

**Z. L. Braho:** Dakord, me pak fjalë për elementët e formës dhe përmbajtjes.

**Znj. I. Osmanaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit 209, datë 11.12.2024 miratoi raportin mbi gjetjet pas vlerësimit të regjistrimeve filmike gjatë implementimit të votimit elektronik në Bashkinë Kamëz, Vorë dhe Elbasan për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. KQZ në vlerësim të pretendimeve për veprimet e operatorëve të caktuar në ditën e votimit ka bërë një shqyrtim të pamjeve filmike, nga shqyrtimi rezultoi se disa prej tyre nuk ofronin pamje të qarta për të nxjerrë konkluzione në mënyrë të përmbushjes së përgjegjësisive nga operatorë e PEVN-së. Nga përmbajtja e kamerave që kishin pamjet filmike, të qarta, u evidentuan disa shkelje të procedurave nga ana e operatorëve në Bashkinë Vorë tre raste, për të cilat operatori asiston dhe ndihmon votuesin. Në Bashkinë Elbasan 12 raste për të cilat prapë operatori asiston dhe ndihmon votuesit përtej mënyrës së udhëzuar nga trajnimi i KQZ-së dhe në Bashkinë Kamëz u evidentuan dy raste për të cilat operatori ndihmon dhe asiston votuesit. Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

“c” e “n” e nenit 2, e nenit 22, pika 8, të Kodit Zgjedhor. Komisioneri i propozon Komisionit të Ankimeve vendosjen e sanksioneve administrative me gjobë në vlerën 3 000 lekë, referuar nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi të elementëve të formës dhe përmbajtjes konstatojmë që i plotëson të tre elementët, në këto kushte vlerësojmë që kjo kërkesë duhet të kalojë për shqyrtim nga ana e KAS.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Po kjo sot është vetëm për elementët e formës dhe përmbajtjes, keni ndonjë gjë për të thënë? Me pak fjalë, jo për themelin, a ke bërë shkelje, a s'ke bërë shkelje?

**Z. E. Çefa:** A je dakord që të shqyrtohet në seancë kjo kërkesë?

**Z. L. Braho:** Ndize mikrofonin.

**Z. O. Deda:** Po.

**Z. L. Braho:** Ti ke qenë i pranishëm kur është bërë kqyrja, s'ke qenë?

**Z. O. Deda:** Jo kam qenë thjesht operator.

**Z. L. Braho:** Po ke qenë ditën e zgjedhjeve në Vorë?

**Z. O. Deda:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 15.01.2025*

**Z. L. Braho:** Dakord. Vetëm se propozimet për sanksione administrative duhet të na vijnë me emër, mbiemër në mënyrë që vendimmarrja në çdo rast të jetë me emra, mbiemra. Dakord atëherë. KAS-i i konsultuar në vend, vendosi ta kalojë për shqyrtim kërkesën nr.1 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit, nr.1 do të caktohet me datë 24 janar, ora 11.00. Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 3**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

15.01.2025  
Ora 11.32

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 14, kërkesë ankimore e depozituar nga TV  
Kopliku.*

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO.
- **Stafi KQZ:** Znj. Ina Osmanaj, Z. Kristi Puleri
- **Të tjerë:** Z. A. Hoxhaj - TV Kopliku, administrator

**Z. L. Braho:** Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 14, kërkesë ankimore e depozituar nga TV Kopliku. E pranishme është trupa e KAS-it, përfaqësuesi i KQZ-së dhe një përfaqësues i ankuesit TV Kopliku.

Keni ndonjë kërkesë paraprake të tipit konflikt interesi, ndonjë gjë të kësaj natyre?

**Z. A. Hoxhaj:** Jo.

**Z. L. Braho:** Dakord. Shkurtimisht na sqaro kërkesën ankimore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka propozuar një gjobë në masën 100 mijë lekë për TV Koplikun. Ju na jeni drejtuar me kërkesën ankimore ne si organ kompetent, ndaj me pak fjalë na thuaj se cilat janë pretendimet tuaja pse kjo gjobë nuk duhet të rrijë në fuqi.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

*p Puleri*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

**Z. A. Hoxhaj:** E thashë edhe një herë, për arsyen e minutazhit. Nuk është se bëjnë pagesë, thjesht në edicionin e lajmeve jemi përpjekur të mbajmë të njëjtin ritëm si te PS-ja, PD-ja, LSI-ja, tek të gjitha partitë. Vetëm për këtë gjë. Atje pak a shumë e shohin krejt, ne media lokale më tepër..., te mediat qendrore bazohen ato, kurse te ne nuk është se bëjnë pagesa, sidomos vitet e fundit. Nëse është në rregull të mos i transmetojnë, edhe i ndalojmë. Po marr shembull të ardhmen për ta ditur si informacion.


**Z. L. Braho:** Pretendimi që ju keni është i ndryshëm nga shkaku për të cilin Komisioneri ka vendosur sanksion. Komisioneri e ka vendosur në bazë të nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor, që thotë mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesa ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6 ndëshkohet me gjobë nga 100-3 milionë lekë.

**Z. A. Hoxhaj:** Cila është fiks mospërgjigjja?

**Z. L. Braho:** Meqenëse edhe ti je i paqartë, t'ia japim fjalën përfaqësuesit të KQZ-së të na sqarojë se për cilat nga këto raste të nenit 173, pika 8, është vendosur gjoba.

**Znj. I. Osmanaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 186, datë 8.10.2024, miratoi raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nëpërmjet këtij raporti, në pikën 103 të tij ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë me vlerën 100 mijë lekë për ofruesin e shërbimit medietik audio-viziv TV Kopluku sipas nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor për

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

mosbashkëpunim me KQZ-në për të marrë informacion në lidhje me reklamat politike.

**Z. K. Puleri:** Neni 8 është edhe sjellja e papërshtatshme, pra informacioni që ne i kemi kërkuar në këtë rast televizionit nuk ka qenë shterues në përgjigjen e tij, që ia ka vënë në dispozicion KQZ-së.

**Z. L. Braho:** Nga provat që kemi ne këtu, është vetëm shkresa që ka sjellë ankimuesi në KQZ, ndërkohë që këtë shkresën nr.1998 nuk e kemi. 1998 është shkresa që i keni dërguar ju në datën 16 korrik 2024. Mund të na e vini në dispozicion?

Nga shkresa e datës 16 korrik 2024 që KQZ i ka dërguar ankimuesit rezulton se nga raporti i AMA-s janë transmetuar reklama politike nga TV Kopliku. Dhe më poshtë i keni thënë që gjeni përlllogaritjet e bëra nga KQZ-ja. Keni bërë disa përlllogaritje me lekë, me sa kuptoj.

**Z. K. Puleri:** Në bazë të tarifave të dorëzuara nga televizioni për transmetimin e reklamave...

**Z. L. Braho:** “Partia e Lirisë- thoni ju - ka deklaruar që ka zero lekë të shpenzuar dhe ndërkohë del 12 mijë e 75 lekë në bazë të tarifave dhe minutave; Partia Socialiste ka deklaruar zero lekë, ndërkohë që i bie 1 milion e 415 mijë lekë, meqenëse janë 74.5 minuta; Partia Konservatore zero lekë dhe duhet të paguante 29 mijë e 215 mijë lekë. Më poshtë gjeni përlllogaritjen e bërë nga KQZ-ja edhe për Partinë Socialdemokrate Për sa më sipër kërkojmë të na sqaroni mbi këto përputhje brenda datës 27.7.2024”. Pra, i keni kërkuar informacion për mospërputhjet. Përgjigjja: “Duke pasur parasysh vendin dhe zonën ku transmetojmë, jemi munduar të mbajmë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

balancën e minutazhit të partive thjesht për efekt të audiencë, që të mos jemi të njëanshëm dhe për pjesën e monitorimit të AMA-s. Për sa i përket pjesës së pagesave, nuk ka paguar asnjë nga këto parti, thjesht kemi mbajtur balancim”.

Çfarë i keni kërkuar më shumë ju? Vetëm për aspektin çfarë keni kërkuar dhe çfarë ka kthyer përgjigje ky. Na sqaroni i keni thënë dhe ju ka sqaruar edhe për lekët, edhe për minutat. Çfarë argumenti keni për këtë pjesë? Çfarë prisnit ju më tepër nga subjekti, çfarë duhet të thoshte në përgjigje më tepër ai që të mos ishin këto kushtet e nenit 173, pika 8?

**Z. K. Puleri:** Ne përgjigjen nga subjekti e kemi vlerësuar të papërshtatshme në kthimin e përgjigjes, sepse televizioni thotë që të jemi në rregull me AMA-n, ndërkohë raporti që ka sjellë AMA tregon qartësisht që është transmetuar reklamë politike dhe reklamë politike falas nuk ka.


**Z. I. Rusmali:** AMA thotë që ju keni transmetuar reklama politike. Thotë të vërtetën AMA, apo gënjen?

**Z. A. Hoxhaj:** Nuk e di si i përshkruan, ndoshta e përshkon te pjesa e lajmeve.

**Z. I. Rusmali:** Reklama është jashtë lajmeve, nuk është kronikë televizive, është reklamë. Subjekti ka pasur të drejtën që nëpërmjet televizionit tuaj të shpërndante mesazhin e vet video. Gënjen AMA, apo jo?

**Z. A. Hoxhaj:** Ato kanë qenë reklama të AMA-s dhe KQZ-së, jo reklama të tjera, siç janë për mënyrën e votimit, kurse këto të tjerat kanë qenë thjesht në lajme,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

emisione, ose speciale, që janë dhënë ndoshta në minutazh 20 minuta, 30 minuta, thjesht për të mbajtur një balancë.

---

**Z. I. Rusmali:** Subjekti thotë që nuk kemi transmetuar reklama. Si do ta vërtetojmë këtë?

**Z. A. Hoxha:** Kush paguan sot atje?

---

**Z. K. Puleri:** Ama e ka qartësisht të ndarë, në momentin kur një televizion paraqet reklamë politike, e ka të ndarë subjekti-reklama, pra, nuk është brenda televizioneve apo thjesht një reportazh.


**Z. I. Rusmali:** Sa minuta reklamë janë evidentuar nga AMA?

**Z. K. Puleri:** Janë të shkresa që ju kemi vënë në dispozicion.

**Z. I. Rusmali:** 220 minuta shkon më shumë në linjën e shpjegimeve të administratorit. Reklama është 30 sekonda herë 10 reklama. Shkon më shumë në logjikë, nuk e di si e ka kriterin AMA. Si e ka kriterin AMA për reklamën politike?

**Z. K. Puleri:** Nga monitorimi që AMA u bën gjithë televizioneve ose televizioneve të tjera, të cilat i dorëzojnë kasetë me regjistrime AMA-s, AMA bën këtë ndarje në lidhje me edicionet e lajmeve, aktorët që përmenden gjatë edicioneve të lajmeve dhe

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

ky i reklamave politike është më vete, është një tabelë më vete e evidentueshme që është dhënë reklamë politike.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë minutazh që këta e kanë vënë në dispozicion të subjekteve. Është minutazh në funksion të subjekteve? Keni dhënë kasetat e subjekteve ju në atë periudhë?

**Z. A. Hoxha:** Ne kemi dhënë në qoftë se ka ardhur një parti në qendër, kemi dhënë një mbledhje, mund të jetë dhënë gjysmë ore, një orë.

**Z. I. Rusmali:** Keni transmetuar aktivitetin e saj. E keni transmetuar ju, apo ju ka ardhur i gatshëm?

**Z. A. Hoxhaj:** Rastet që mund të kenë qenë në Koplik e keni filmuar ne. Shumicën e rasteve i kemi marrë nga kanali i tyre, siç transmetojnë në *youtube* ose *facebook*.

**Z. I. Rusmali:** Dhe nuk keni marrë lekë?

**Z. A. Hoxhaj:** Për këtë pjesë jo.

**Z. E Çefa:** Për administratën se duket sikur praktika është lënë në mes nga ju, praktisht siç e lexoj unë. Subjekti ia ka lënë topin KQZ-së. I ka kthyer përgjigje. Vetëm arsyetimi që nuk ka kthyer përgjigje nuk qëndron. Kjo është pak, por e sigurt. Ai e ka kthyer përgjigjen. Mund të jetë përgjigjja e paplotë, mund të jetë një përgjigje që ndikon për një hetim më të thelluar në një tjetër drejtim që duhet ta bënte KQZ-ja. KQZ-ja ka stopuar këtu. Normalisht duhet ta kishte shtjelluar, duhet të kishte

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*


marrë shtysë nga përgjigjja dhe duhet të kishte verifikuar nëse vërtet subjektet nuk kanë paguar dhe çfarë ndodh nëse nuk kanë paguar. Si klasifikohet, a ka shkelje? Si klasifikohet shkelja? Këtu gjendet dispozita përkatëse në Kod për të sanksionuar ose subjektin televiziv, ose subjektin politik përkatës. Kështu siç e keni lënë, e keni mbyllur gjënë. Ndërkohë fjala ishte për ju, duhet të kishit vepruar. Nuk duhet të kishit thënë, jo nuk më pëlqen mua kjo përgjigjja jote dhe nuk e quaj që bashkëpunove. Ashtu mendon ai, e jep përgjigjen me një rresht. A ka një dispozitë tjetër që mund të klasifikohet fakti që subjektet politike nuk kanë paguar sipas deklaramit të televizionit? E pranon faktin që ka transmetuar spote televizive politike dhe pranon faktin që këto parti politike apo kandidatët nuk kanë paguar. Ka një dispozitë në Kod që e ndalon këtë?

**Z. I. Rusmali:** Nga deklaramet këtu, si e kuptoj unë, pranon edhe faktin që nuk ka prerë faturë.

**Z. A. Hoxhaj:** Nuk është prerë fatura.

**Z. I. Rusmali:** Pra, e pranon dhe faktin që nuk është prerë faturë. Jemi përpara kësaj situatë. Dhurimi në natyrë nga ana e subjektit është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit? Eventualisht dhurimi në natyrë nga ana e subjektit, i padeklaruar nga subjektet politike, ato tre subjektet politike, çfarë efekti ka mbi sjelljen, mbi raportimin financiar të subjekteve politike? Këto janë dy çështje që ju duhet t'i zgjidhni dhe eventualisht duhet edhe të procedoni. Në qoftë se subjekti ka shkelur dispozitat për dhurimin në natyrë, duhet të kërkonte penalizimin e subjektit për shkelje të dispozitave të dhurimit në natyrë. Në qoftë se subjektet politike kanë shkelur dispozitat për raportimin e financimeve, duhet të reagoni e të merrni masa

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

ndaj subjekteve për shkelje dhe është fakt i provuar, sepse elementet e provës ju i keni të gjitha. Ju keni deklaratimet e subjekteve zero lekë, keni deklaratimin e faktit nga AMA për transmetimin e fushatës politike nga subjektet nga ky rrjet televiziv dhe keni deklaratimin e rrjetit televiziv që thotë unë nuk kam marrë lekë për këtë punë. Është e vërtetë që unë kam transmetuar fushatë politike në televizionin tim, por unë nuk kam marrë lekë. Çfarë doni më shumë se kaq?

**Z. L. Braho:** Shoh që televizionet e tjera i keni gjobitur bazuar te neni 84, kalimi i minutazhit, gjëra të kësaj natyre ose kur keni pasur raste të tjera kur nuk kanë paraqitur tarifa. Mosbashkëpunimi sikur nuk mbështetet shumë nga faktet e çështjes. Keni gjë tjetër si përfundim? Çfarë kërkon nga KAS-i?

**Z. A. Hoxhaj:** Shuarjen e gjobës. Unë e kuptoj që është gabim, nuk bëhet fjalë, si rregull nuk duhet asnjë sekondë, unë e shpjegova pjesën e transmetimit.

**Z. L. Braho:** Dakord. Tërhiqemi për vendim dhe do t'ju njoftojmë.

**Riçelet seanca**

**Ora 12:00**

**Z. L. Braho:** Riçelim seancën e shqyrtimit administrativ për kërkesën ankimore nr. 14, të O.SH.M.A TV Kopliku. KAS, pasi u tërhoq për vendim, vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore të TV Koplikut;
- Shfuqizimin e vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sa i përket pikës 103 të dispozitivit për caktimin e masës administrative 100 000 lekë për O.SH.M.A TV Kopliku sipas nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor;

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.15.01.2025*

- Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 2.500 lekë në zbatim të nenit 171, pika 2, të Kodit Zgjedhor për TV Kopliku, sepse nuk jemi në kushtet e nenit 173, pika 8, siç ka arsyetuar Komisioneri për aq kohë sa nga provat u vërtetua që ka pasur një bashkëpunim dhe një përgjigje nga ana e TV Koplikut. Duke qenë se dhurimi nga autoritetet media-vizive është i ndaluar, gjithsesi kemi një shkelje nga TV Kopliku dhe kjo shkelje klasifikohet sipas nenit 171, pika 2, të Kodit Zgjedhor.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e vendimit.
- U shpall sot në datën 15 janar 2025. Seancën e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 4**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

